

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konsensus i rrallë në Kuvend: Miratohet deklarata në unison kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/konsensus-i-rralle-ne-kuvend-miratohet-deklarata-ne-unison-kunder-denim-it-te-ish-krereve-te-uck-se-ne-hage/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:48:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:41:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e5eb1335a36fa010ee767e3b9d1b2df54ce6b964636117c7cf47192c10c60c97
TEKSTI	031cadb8abd849be25262fa4ffddbc0a003d1e717e41b19da2d75ce920433195
PAMJA	c105bf7733f23a521b18d950dbbeded711cf2626a2734ba4980b4f693eb46d11

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c4f600a1fbff3d1084b1d35ad9f84bdd94b664a9da3b9b624535698680d0058
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4c4f600a1fbff3d1084b1d35ad9f84bdd94b664a9da3b9b624535698680d0058

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Konsensus i rrallë në Kuvend: Miratohet deklarata në unison kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë

KRYESORE

Demo

Konsensus i rrallë në Kuvend: Miratohet deklarata në unison kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë

SEPTEMBER 17, 2026



Kuvendi i Shqipërisë ka mbajtur një qëndrim të prerë dhe unanim kundër vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë për dënimin e ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Përmes një deklarate të përbashkët, të lexuar nga kryeparlamentari Niko Peleshi, deputetët e të gjitha krahëve politikë u bashkuan në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke shprehur bindjen e plotë në pafajësinë e tyre.

Dokumenti, i cili mori duartrokitjet e të gjithë të pranishmëve në sallë, vjen si një reagim institucional ndaj aktgjyqimit, duke e konsideruar atë një përpjekje të papranueshme për të rishkruar historinë dhe për të relativizuar krimet e regjimit të Slobodan Milosheviçit.

Lufta e UÇK-së, një e vërtetë historike e patjetërsueshme

Në tekstin e deklaratës theksohet se lufta e UÇK-së ishte një reagim legjitim ndaj spastrimit etnik dhe gjenocidit sistematik serb.

“Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën,” thuhet në deklaratë.

Kuvendi ngriti shqetësimin edhe për standardet e dyfishta në rajon, duke dënuar glorifikimin që i bëhet kriminelëve të luftës në Serbi, si dhe instrumentalizimin politik të këtij procesi nga Beogradi dhe Moskë për të delegitimuar shtetësinë e Kosovës.

Duke e konsideruar këtë vendim si jo “fjalën e fundit”, pasi pritet ndjekja e shkallëve të tjera të gjyqimit, Kuvendi i Shqipërisë mori disa zotime konkrete. Shqipëria do të denoncojë në të gjitha forumet ndërkombëtare aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale të ushtruar nga regjimi i Milosheviçit; Do të kërkohet llogaridhënie nga autoritetet serbe për mungesën e angazhimit të tyre në vendosjen e drejtësisë për viktimat; Do të nisë një koordinim i ngushtë me Kuvendin e Kosovës, duke u bërë thirrje të dyja qeverive respektive që të nisin veprime të përbashkëta për korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.

DEKLARATË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

“MBI AKTGJYKIMIN E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË PËR HASHIM THAÇIN, KADRI VESELIN, REXHEP SELIMIN DHE JAKUP KRASNIQIN”

Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjatën e thellë dhe mosdakordësinë e plotë me një vendim që e

Postimet e reja

Konsensus i rrallë në Kuvend: Miratohet...

SEPTEMBER 17, 2026

Protestuesit bllokojnë Rrugën e Elbasanit me...

SEPTEMBER 17, 2026

Protesta / Qytetarët sulmojnë me vezë e...

SEPTEMBER 17, 2026

Peleshi: Deklaratë e përbashkët në Kuvend...

SEPTEMBER 17, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të “Grant 2026” kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe “problematicët”

Na ndiq

Facebook

Instagram

konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

YouTube

TikTok

Kuvendi i Shqipërisë rritet një të vërtetë historike që nuk mund të relativizohet: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes dhe për të fituar të drejtën për të jetuar të lirë në vendin e vet. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, dhunës, spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga regjimi i Slobodan Milosheviçit. Pa luftën dhe sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtimit gjakatar serb, historia e çlirimit të Kosovës nuk mund të kuptohet. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës dhe e rrugës që çoi drejt çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së saj. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj.

Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën. Nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së.

Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për standardet e dyfishta në trajtimin e së kaluarës së përgjakshme të rajonit. Nderimet publike dhe shtetërore që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte, si edhe glorifikimi i figurave të lidhura me gjenocidin dhe spastrimin etnik, përfshirë Ratko Mladiçin, cenojnë kujtesën e viktimave, pengojnë pajtimin dhe bien ndesh me vlerat europiane. Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës. Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën, popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre.

E palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që:

Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat.

Të koordinojë veprimet me Kuvendin e Kosovës, dhe i bën thirrje të dyja Qeverive tona që gjithashtu të koordinojnë veprimet, me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.

Haga Kuvendi i Shqipërisë

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radar.lajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.